

Mikaela Minga(1983-). Etnomuzikologe pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Arteve – Qendra e Studimeve Albanologjike; pedagoge e ftuar pranë Universitetit të Arteve për periudhën 2006–2017. Jep ciklet e leksioneve mbi *muzikën* dhe *filmin* (Fakulteti i Artit Skenik) *Jazz* dhe *Popular Music* dhe *analizë e formave muzikore*(Fakulteti i Muzikës). Ka kryer shkollën e mesme artistike "Tefta Tashko Koço", në Korçë (2002), me diplomën "Shkëlqyeshëm" në degën e pianos. Mbaroi studimet për muzikologji në Fakultetin e Muzikës në Tiranë (2006), me medalje të artë. Në vijim kreu master të nivelit të dytë në muzikologji, pranë po këtij fakulteti (2006–2007). Studimet doktorale i ka zhvilluar pranë Universitetit të Milanos, në shkollën doktorale "Storia e critica dei beni artistici e ambientali" (2010–2013), me një qëndrim në New York (2011–2012), si *visiting scholar në Graduate Center* – CUNY, City University of New York.

Mikaela Minga ka dhënë kontributin e vet në fushën e botimeve mbi muzikën, duke filluar nga viti 2006. Ndër librat e botuar janë: *Ku ka muzikë* (2006), *Luciano Berio dhe Folk Songs* (2008), *Spanja Pipa e la canzone urbana di Korça* (2015). Ka botuar gjithashtu artikuj në revista shkencore, si: *Kultura Popullore* (2015, 2016); *Archivio di Etnografia* (2016); *Ethnologie française* (2017).